



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**ZP.Anr.75/2026**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së Bekim Haxhiut kandidat për deputet nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/156-2026 i datës 31.01.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datën 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 03.02.2026, merr këtë,

#### **V E N D I M**

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.75/2026, e datës 02.02.2026, e parashtruar nga Bekim Haxhiu, kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të anulohet të gjitha fletëvotimet e pranuar me postë pas datës 29.12.2025 të cilat janë përfshirë edhe në rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ, më datë 31 Janar 2026, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025.

*A r s y e t i m*

Më datë 02.02.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.75/2026 nga Bekim Haxhiu kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, Nr. 01/156-2026 i datës 31.01.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datën 28 Dhjetor 2025, në të cilën thekson se kjo ankesë parashtrohet në pajtim me nenin 106 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, sipas të cilit personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e rezultateve përfundimtare. Duke qenë se KQZ ka shpallur rezultatet përfundimtare më 31.01.2026 në ora 11:00, ankesa e tanishme paraqitet brenda afatit ligjor 48-orësh liga kjo shpallje dhe është e pranueshme si liga aspekti formal ashtu edhe procedural.

Parashtruesi i ankesës thekson se, pranueshmëria dhe kompetenca e PZAP-it për shqyrtim meritor në këtë fazë burojnë nga vetë neni 106, i cili e koncepton procesin e certifikimit të rezultatit përfundimtar si të kushtëzuar nga përmbyllja e procedurave ankimore dhe vendosja e tyre. Kjo nënkupton se ligjvënësi ka paraparë shprehimisht një mekanizëm korrigjues pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, pikërisht për t'u mundësuar palëve që të kontestojnë shkeljet që ndikojnë në rezultatin final, përfshirë edhe shkeljet që lidhen me administrimin e numërimit dhe vlefshmërinë e një kategorie të tërë fletëvotimesh.

Neni 96, i LZP-së rregullon votimin jashtë Kosovës dhe përcakton kriter të prerë për vlefshmërinë e fletëvotimit me postë, duke vendosur afatin maksimal dhe absolut për pranimin e fletëvotimeve: deri të nesërmen e ditës së zgjedhjeve në orën 16:00, me kusht që të kenë vulë postare para ditës së zgjedhjeve. Ky rregull nënkupton se afati maksimal për pranimin e fletëvotimeve me postë ka qenë data 29 dhjetor 2025, ora 16:00.

Pavarësisht këtij afati ligjor, KQZ ka ndërmarrë veprime administrative që në praktikë kanë mundësuar tërheqjen dhe administrim të pakove me fletëvotime edhe pas afatit ligjor, çka është konfirmuar edhe me njoftime publike lidhur me pakot e tërhequra dhe të proceduara në fillim të janarit 2026, të cilat janë futur në procedurë verifikimi dhe numërimi dhe janë reflektuar në rezultatet e publikuara. Thelbi i kësaj ankese ndërlidhet me faktin se ato janë trajtuar si të vlefshme dhe janë përfshirë në llogaritjet zgjedhore, ndonëse janë pranuar pas afatit të paraparë shprehimisht nga neni 96 paragrafi 2.

KQZ, sipas njoftimit zyrtar të datës 07.01.2026, ka bere të ditur se në vazhdim të procesit të numërimit do të përfshihen fletëvotimet nga votimi përmes postës të tërhequra më 2 dhe 5 janar 2026, duke specifikuar se më 2 janar janë tërhequr 8,180 pako me fletëvotime nga 9 kuti postare jashtë Kosovës, ndërsa më 5 janar janë tërhequr edhe 11,867 pako me fletëvotime nga 13 kuti postare dhe 3,185 pako me fletëvotime nga 5 kuti postare, në total 23,232 pako me fletëvotime nga 13 kuti postare janë administruar dhe numëruar deri më datë 09.01.2026 sipas njoftimit zyrtarë të KQZ.

Parashtruesi i ankesës shton se pa ligjshmëria e përfshirjes së votave me postë pas afatit ligjor në rezultat, ka mbetur e pa trajtuar, dhe se rruga efektive për trajtim meritore, në momentin kur shkelja materializohet përmes aktit përfundimtar të shpalljes së rezultateve, realizohet përmes ankesës sipas nenit 106 paragrafi 3.

Pranimi dhe numërimi i fletëvotimeve pas afatit të 29.12.2025 ora 16:00 përbën shkelje të drejtpërdrejtë dhe flagrante të nenit 96 paragrafi 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ky afat nuk është udhëzues, as i negociueshëm, por kusht thelbësor për vlefshmërinë e votës. Në të drejtën zgjedhore, afatet që përcaktojnë mbylljen e procesit të votimit dhe pranimin e fletëvotimeve janë garanci e integritetit të procesit dhe barazisë së votës, sepse sigurojnë që rezultati të prodhohet nga një trup votuesish i mbyllur në kohë dhe i trajtuar njësoj.

KQZ është organ administrativ kushtetues dhe nuk ka asnjë kompetencë ligjore për të ndryshuar, zgjatur, pezulluar apo relativizuar një afat të përcaktuar shprehimisht me ligj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Vendimi administrativ Nr. 01/3794-2025, në masën që në praktikë lejon pranimin dhe numërimin e fletëvotimeve pas afatit ligjor, është veprim jashtë kompetencës (ultra vires) dhe përbën zhvendosje të standardit ligjor me akt nënligjor, gjë që bie ndesh me parimin e ligjshmërisë sigurisë juridike dhe hierarkinë e normave.

Në këtë mënyrë, KQZ ka krijuar një standard paralel, jo-ligjor, për vlefshmërinë e votës, duke e shndërruar shkeljen nga një episod i izoluar në praktikë të institucionahzuar. Konfirmimi publik i tërheqjes dhe futjes në numërim të pakove të tërhequra më 2 dhe 5 janar 2026 dëshmon faktin se jo vetëm që ka ndodhur pranimi pas afatit, por është vendosur si politikë operative e procesit të numërimit.

Pranimi dhe numërimi i fletëvotimeve pas afatit ligjor nuk mund të trajtohet si gabim procedural, sepse prek vetë kufirin kohor të procesit të votimit. Fakti se këto vota janë pranuar jashtë afatit, ato, në substancë, e hapin procesin e votimit pas mbylljes së tij dhe e zgjeron trupin

e votës në mënyrë arbitrare, duke e bërë rezultatin të varur nga një praktikë administrative dhe jo nga norma ligjore.

Kjo paligjshmëri ka efekt zinxhir në të gjitha komponentët e rezultatit, pasi që rrit numrin e votave të përfshira në shpërndarjen e mandateve, ndryshon përcjell relative të votës, transformon rezultatet brenda listave të hapura dhe, në fund, prodhon renditje të ndryshme të kandidatëve me shpërndarje të ndryshme të mandateve. Kjo nuk është vetëm çështje e "votave të diasporës", por çështje e barazisë së votës dhe e integritetit të procesit në tërësi.

Si kandidat për deputet, ankuesi preket drejtpërdrejt nga administrimi i kundërligjshëm i fletëvotimeve me postë të pranuar pas datës 29.12.2025 ora 16:00, sepse këto fletëvotime ndikojnë në numrin e përgjithshëm të mandateve të subjektit politik PDK, si dhe në renditjen përfundimtare të kandidatëve brenda listës së hapur. Pasojat nuk janë abstrakte, pasi që administrimi i votave të pranuar më postë pas afatit ligjor, i ka shkaktuar PDK-së rënie nga 23 dhe 22 mandate, dhe se ankuesi është identifikuar si kandidati që e humb ulësen në këtë ndryshim të mandateve.

Prandaj është e qartë se çdo votë e paligjshme e futur në llogaritje e shtrembëron konkurrencën brenda listës së hapur dhe e ndryshon renditjen e kandidatëve, dhe e bërë mandatin jo rezultat të vullnetit të shprehur në mënyrë të ligjshme, por produkt të një procesi të kontaminuar nga vota jashtë afatit.

Praktikisht, 28,555 pako me fletëvotime me postë janë pranuar brenda afatit ligjorë sipas Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenin 96, paragrafi 2 dhe nuk janë objekt i ankesës. Ndërsa, 23,232 pako me tetë votime me postë janë pranuar pas afatit ligjor dhe janë objekt i ankesës, sepse janë të pa ligjshme dhe të barabarta me situatën hipotetike ku si të vlefshme do të pranoheshin edhe votat pas mbylljes së Qendrave të Votimit në Kosovë, më datë 28.12.2025, në ora 19:00.

Kërkon nga PZAP-i që të aprovohet si e bazuar ankesa e parashtruar nga kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, Bekim Haxhiu, të urdhërohet KQZ që të anulohet të gjitha fletëvotimet e pranuar me postë të pranuar pas datës 29.12.2025 ora 16:00 dhe të përjashtojë nga numërimi të gjitha fletëvotimet me postë të pranuar pas këtij afati, të cilat janë përfshirë edhe në rezultatet përfundimtare të shpallur nga KQZ më datë 31 janar 2026, si dhe të urdhërohet KQZ të bëjë rishikimin e rezultatit zgjedhor pa përfshirjen e këtyre fletëvotimeve, në përputhje me nenin 13 paragrafi 12 nën paragrafi 12.2 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave.

Në përgjigje në ankesë KQZ sqaron se me datën 22.12.2025, ka miratuar Procedurën për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e pranimi dhe organizimi të zarfeve nga votimi përmes postës jashtë Kosovës në QNR, duke shpjeguar hapat konkret që duhet të ndiqen pas pranimi të materialeve nga votimi përmes Postës jashtë Kosovës.

Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2025 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës; 17. Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR. Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të

listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike.

Procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Krahas fletëvotimeve, në ekran është prezantuar edhe pamja e sistemit elektronik ku figurojnë numrat e kandidatëve të cilët regjistrohen në sistem.

Më datë 10.12.2025, KQZ nxori vendimin me numër 01/3794-2025 për miratimin e afateve dhe veprimeve operacionale për dërgimin dhe pranimin e pakove me fletëvotime përmes postës. Duke u bazuar në rekomandimin e Sekretariatit dhe duke marrë parasysh afatet e përcaktuara me vendimin e KQZ-së të datës 07.12.2025 (mbi kërkesat dhe specifikimet për shërbimet postare për votimin jashtë Kosovës), është konstatuar se për shkak të dështimit të kontraktimit të operatorit ekonomik për shërbime postare, afatet e parashikuara fillimisht nuk ishin më të realizueshme.

Në këto rrethana, me qëllim të garantimit të së drejtës së votës dhe përmbushjes së detyrimit për dërgimin e fletëvotimeve tek votuesit jashtë vendit, KQZ-ja ka bërë plotësimin dhe ndryshimin e afateve për dërgimin e pakove. Vendimi specifikon po ashtu se tërheqja e pakove me fletëvotime bëhet me datë 02.01.2026, përveç në rastet kur shërbimet postare nuk operonin në këtë datë për shkak të festave të fund vitit dhe duke qenë se datat 3 dhe 4 janar ishin ditë vikendi, tërheqja duhej të bëhej në ditën pasuese të punës, përkatësisht më 05.01.2026. Gjatë procesit të vendimmarrjes janë marrë parasysh vonesat që festat e fund vitit shkaktojnë në procedimin e kthimit të pakove nga 22 shtete të ndryshme drejt Kosovës. Kjo vendimmarrje është bazuar plotësisht në Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht në Nenin 5, paragrafin 6, i cili autorizon KQZ-në që, në proceset e zgjedhjeve të parakohshme, të ndryshojë afatet kohore sipas nevojës dhe në pajtim me rrethanat e krijuara. Po ashtu si shembull pas komunikimit me Postën në Shtetin e Zvicrës të njëjtit kanë konfirmuar se data 29.12.2025 nuk ishte ditë pune dhe nuk mund të bëhej tërheqja e pakove me fletëvotime.

Vendimi i KQZ për shkurtimin e afateve, i miratuar më 10.12.2025, është miratuar me votat e të gjithë Anëtarëve të KQZ-së, për çka kishte pajtueshmëri në mesin e të gjithë Anëtarëve të KQZ-së, dhe se përveçse nuk është kontestuar nga asnjë palë, ka orientuar secilin akter që të veprojë në përputhje me këto afate të përcaktuara. Po ashtu, votuesit kanë qenë të njoftuar që para ditës së zgjedhjeve se deri në cilën datë duhet të arrijnë dërgesat postare nga vendi përkatës. Për të përmbushur parimet ligjore të para shikueshmërisë dhe të sigurisë juridike, vendimi ka qenë publik. Ndryshimi i rregullave pasi që janë pranuar zarfet cenon sigurinë juridike. KQZ përmes Zyrtarëve të Përfaqësive Diplommatike ka realizuar procesin e tërheqjes së pakove me fletëvotime në disa faza përgjatë periudhës dhjetor 2025 - janar 2026, duke përfshirë gjithsej 22 kuti postare në vende të ndryshme dhe në Kosovë.

Procesi nisi më 23 dhjetor 2025 me tërheqjet fillestare në Bernë (8,000 pako) dhe Berlin (10,511 pako), duke u pasuar më 29 dhjetor me një sasi shtesë prej 10,044 pakosh po ashtu nga Berlini. Faza tjetër u realizua më 2 janar 2026, datë në të cilën u procesuan tërheqjet në një

numër të madh qendrash ndërkombëtare si: Praga, Londra, Zagrebi, Stokholmi, Stambolli, Nju Jorku, Kopenhaga, Kanbera dhe Parisi.

Së fundmi, për shkak të festave dhe ditëve të vikendit, tërheqja u përmyll më 5 janar 2026. Në këtë datë u realizua tërheqja në Prishtinë dhe në qendra të tjera si: Vjena, Brukseli, Oslo, Roma, Lubjana, Budapesti, Shkupi, Tirana, Haga, Otava, Podgorica, si dhe sasi të mbetura nga Berna dhe Berlioni. Ky koordinim i datave reflekton përshtatjen e procesit operacional me funksionalitetin e shërbimeve postare dhe kalendarin e festave zyrtare, duke siguruar grumbullimin e pakove me fletëvotime nga të gjitha kutitë postare,

Një praktikë e tillë është aplikuar edhe në Zgjedhjet Lokale 2025, përkatësisht në Raundin e dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave të mbajtur me date 9 nëntor 2025, ku KQZ kishte vendosur që për shkak të afatit të shkurtë në dispozicion për votuesit që të kthejnë fletëvotimet, tërheqja të bëhej me date 11.11.2025 dhe në vendet ku data 11.11.2025 ishte festë zyrtare tërheqja të bëhej në ditën vijuese të punës respektivisht me datë 12.11.2025.

Në këtë kuptim, në numërimin e datës 7 janar, përveç fletëvotimeve të numëruara nga tërheqjet e bëra me datë 2 dhe 5 janar 2026, kishte edhe zarfe me fletëvotime të cilat i takonin tërheqjeve të mëhershme e të cilat nuk janë numëruar për faktin se ishin në numër të vogël dhe sipas Procedurës duhej të bashkohej me fletëvotime të njëjtës komunë nga tërheqjes e radhës deri në plotësimin e kriterit rreth 300 fletëvotime në një kuti apo vendvotim. Gjatë procesit të vlerësimit të pakove me fletëvotime përmes postës, janë refuzuar 149 zarfe të cilat kishin arritur në kutitë postare pas datës 27 dhjetor 2025.

Sipas Procedurës së QNR-së, pas vlerësimit të pakove me fletëvotime nga Shërbimi Votues, zarfet e fshehtësisë me fletëvotime vendosen në kuti të votimit me nga 300 fletëvotime sipas komunës në Kosovë të cilës i talon votuesi i regjistruar për votim jashtë Kosovës. Konkretisht, zarfet e fshehtësisë me fletëvotime janë ndarë në kuti të votimit për të cilat janë krijuar vendvotimet dhe janë procesuar për numërim. Në këtë kuptim, në numërimin e datës 7 janar, përveç fletëvotimeve të numëruara nga tërheqjet e bëra me datë 2 dhe 5 janar 2026, kishte edhe zarfe me fletëvotime të cilat i takonin tërheqjeve të mëhershme e të cilat nuk janë numëruar për faktin se ishin në numër të vogël dhe sipas Procedurës duhej të bashkohej me fletëvotime të njëjtës komunë nga tërheqjes e radhës deri në plotësimin e kriterit rreth 300 fletëvotime në një kuti apo vendvotim. Gjatë procesit të vlerësimit të pakove me fletëvotime përmes postës, janë refuzuar 149 zarfe të cilat kishin arritur në kutitë postare pas datës 27 dhjetor 2025.

Lidhur me pretendimet e ankuesit, i cili i referohet praktikës së vendosur me Vendimin A.A. Nr. 17/2019, KQZ sqaron se ky precedent nuk është relevant për rastin në fjalë. Kjo vjen si pasojë e faktit se vendimi i cituar ishte nxjerrë në kohën kur ishte në fuqi Ligji Nr. 03/1—073, i cili tashmë është shfuqizuar. Vendimi që kontestohet nga ankuesi bazohet në Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili ka sjellë ndryshime substanciale, sa i përket votimit përmes postës; në afatet dhe kutitë postare jashtë Kosovës. Për rrjedhojë, parimet apo interpretimet e vjetra ligjore nuk mund të aplikohen në mënyrë analoge mbi dispozitat e ligjit të ri, i cili rregullon në mënyrë specifike dhe të ndryshme pranimin e pakove me fletëvotime të votuesve jashtë Kosovës.

Përcaktimi i afateve nga ana e KQZ-së nuk përbën vetëm një veprim administrativ të bazuar në Nenin 5, paragrafin 6 të Ligjit Nr. 08/L-228, por është një veprim i domosdoshëm për të garantuar parimin e gjithë përfshirjes dhe realizimin efektiv të së drejtës së votës, të garantuar me Nenin 45 të Kushtetutës së Kosovës, sepse në të kundërtën shkurtimi dhe kufizimi i afateve

të tërheqjes do të rezultonte në pamundësinë teknike të mijëra votuesve jashtë vendit për të pranuar dhe kthyer fletëvotimet e tyre brenda kohës. Prandaj, përshtatja e kalendarit të tërheqjeve ishte mjeti i vetëm që mundëson përfshirjen e votuesve në procesin vendimmarrës, duke parandaluar përjashtimin e tyre de facto nga zgjedhjet.

Njëkohësisht, ankesa e dorëzuar me datë 02.02.2026 është e pasafatshme, pasi në këtë ankesë kontestohet ndër të tjera edhe vendimi i KQZ-së i datës 10.12.2025, ndërsa veprimet operacionale të tërheqjes së pakove me fletëvotime janë realizuar më 02 dhe 05 janar 2026.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, ka gjetur se:

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet e parashtruesit të ankesës i cili pretendon se, KQZ kundërligjshëm ka pranuar fletëvotimet me postë pas datë 29.12.2025 të cilat janë përfshirë edhe në rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ, më datë 31 Janar 2026, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, për Panelin janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pretendon pala ankuese me ankesën e tij.

Sa i përket këtyre pretendimeve ankimore se në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ, janë përfshirë votat të pranuara përmes postës pas afatit ligjor, KQZ në përgjigjen në ankesë ka sqaruar se të njëjtat janë pranuar duke u bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2025 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës, ku parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR. Procesi i numërimit të votave në QNR është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) dhe se rezultatet KQZ i ka shpallur pas numërimit të të gjitha fletëvotimeve.

Paneli vlerëson se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese për faktin se nuk mund të vërtetohet se ka pasur parregullsi gjatë pranimi të votave me postë dhe se të njëjtat janë përfshirë në rezultatet përfundimtare ashtu siç pretendon pala ankuese. Paneli, nuk mundi të vërtetoj një pretendim të tillë për faktin se pala ankuese pretendimet e tij nuk i ka mbështetur në prova bindëse se njëjti ka qenë i jashtë afatit të pranuar, aq më tepër kur vendimi i KQZ për shkurtimin e afateve, i datës 10.12.2025, është miratuar me votat e të gjithë Anëtarëve të KQZ-së, për çka kishte pajtueshmëri në mesin e të gjithë Anëtarëve të KQZ-së duke përfshi edhe përfaqësuesin e subjektit politik në KQZ nga vjen edhe ankuesi, dhe se përveçse nuk është kontestuar nga asnjë palë, ka orientuar secilin akterë që të veprojë në përputhje me këto afate të përcaktuara, e i cili vendim nuk është atakuar në PZAP-së brenda afateve ligjore për ankesë, për çka edhe tanimë kjo çështje konsiderohet se ka marrë epilog sa i përket rregullsisë së pranimi të votave me postë.

Andaj pretendimet e ankuesit mbetet vetëm në suaza të dyshimit se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave me postë në QNR. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj, për

faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka arritur që të vërtetohen pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
ZP.Anr.75/2026 më datën 03.02.2026

Kryesues i Panelit  
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.11/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Delushe Halimi dhe Rustem Thaqi, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së kandidat për deputet nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Bekim Haxhiut, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datën 28 Dhjetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.75/2026, të datës 03.02.2026, në seancën e mbajtur më datë 09.02.2026, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e kandidat për deputet nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Bekim Haxhiut, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.75/2026, të datës 03.02.2026, VERTETOHET.

### A r s y e t i m i

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZP.Anr.75/2026, të datës 03.02.2026, ka vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa ZP.Anr. 75/2026, e datës 02.02.2026, e parashtruar nga Bekim Haxhiu, kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të anulohet të gjitha fletëvotimet e pranuar me postë pas datës 29.12.2025 të cilat janë përfshirë edhe në rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ, më datë 31 Janar 2026, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025.

Kundër vendimit të lartpërmendur, kandidati për deputet nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Bekim Haxhiut, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e parashtruar të anulohet vendimi ZP.Anr.75/2026, i datës 03.02.2026, i Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, të konstatohet se përfshirja në rezultatin zgjedhor e fletëvotimeve me postë të administruara pas afatit të përcaktuar me nenin 96 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-228 është në kundërshtim me ligjin, të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të anulohet të gjitha fletëvotimet e pranuar me postë pas afatit ligjor.



dhe të përjashtojë nga numërimi të gjitha fletëvotimet me postë të pranuar pas këtij afati, përfshirë 23 232 pako me fletëvotime të pranuar më 02.01.2026, 05.01.2026 dhe 08.02.2025 dhe të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të bëjë rishikimin e rezultatit zgjedhor pa përfshirjen e këtyre fletëvotimeve, në përputhje me nenin 13 paragrafi 12 nënparagrafi 12.2 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të kandidati për deputet nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Haxhiut, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.Anr.75/2026, i datës 03.02.2026.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 02.02.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr. 75/2026 nga Bekim Haxhiu kandidat për deputet nga subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, Nr. 01/156-2026 të datës 31.01.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datën 28 Dhjetor 2025, për anulimin e fletëvotimeve me postë të pranuar pas afatit ligjor, duke kërkuar më saktësisht si në ankesën e parashtruar në PZAP.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e kandidati për deputet nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Haxhiut.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZP.Anr.75/2026, të datës 03.02.2026, me të cilën e ka refuzuar ankesën e kandidati për deputet nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Bekim Haxhiut, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Pretendimet e parashtruesit të ankesës i cili pretendon se, KQZ kundërligjshëm ka pranuar fletëvotimet me postë pas datë 29.12.2025 të cilat janë përfshirë edhe në rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ, më datë 31 Janar 2026, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, për Panelin janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pretendon pala ankuese me ankesën e tij.

Sa i përket këtyre pretendimeve ankimore se në rezultatit përfundimtar të shpallur nga KQZ, janë përfshirë votat të pranuar përmes postës pas afatit ligjor, KQZ në përgjigjen në ankesë ka sqaruar se të njëjtat janë pranuar duke u bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2025 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës, ku parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet



që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR. Procesi i numërimit të votave në QNR është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) dhe se rezultatet KQZ i ka shpallur pas numërimit të të gjitha fletëvotimeve.

Paneli vlerëson se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese për faktin se nuk mund të vërtetohet se ka pasur parregullsi gjatë pranimit të votave me postë dhe se të njëjtat janë përfshirë në rezultatet përfundimtare ashtu siç pretendon pala ankuese. Paneli, nuk mundi të vërtetoj një pretendim të tillë për faktin se pala ankuese pretendimet e tij nuk i ka mbështetur në prova bindëse se i njëjti ka qenë jashtë afatit të pranuar, aq më tepër kur vendimi i KQZ për shkurtimin e afateve, i datës 10.12.2025, është miratuar me votat e të gjithë Anëtarëve të KQZ-së, për çka kishte pajtueshmëri në mesin e të gjithë Anëtarëve të KQZ-së duke përfshi edhe përfaqësuesin e subjektit politik në KQZ nga vjen edhe ankuesi, dhe se përveçse nuk është kontestuar nga asnjë palë, ka orientuar secilin akterë që të veprojë në përputhje me këto afate të përcaktuara, e i cili vendim nuk është atakuar në PZAP-së brenda afateve ligjore për ankesë, për çka edhe tanimë kjo çështje konsiderohet se ka marrë epilog sa i përket rregullsisë së pranimit të votave me postë.

Andaj pretendimet e ankuesit mbetet vetëm në suaza të dyshimit se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave me postë në QNR. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e parashtruara në ankesë nuk ka arritur që të vërtetohen pretendimet e theksuara si më lartë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruar nga kandidati për deputet nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Haxhiut, lidhur me pretendimet për anulimin e të gjitha fletëvotimeve të pranuar me postë pas afatit ligjor, dhe të përjashtojë nga numërimi të gjitha fletëvotimeve me postë të pranuar pas këtij afati, përfshirë 23,232 pako me fletëvotime të pranuar më datat 02.01.2026, 05.01.2026 dhe 08.02.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e PZAP-së edhe për zbatim të së drejtës materiale për arsye se:

Me nenin 119 paragrafi 1 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: 1. Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrtojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”.

Me nenin 86 paragrafi 1 të LZP-së, përcaktohet se: “KQZ-ja vendos rregullat e procedurës, shpërndarjet, pranimin, paketimin, transportin dhe sigurinë e materialeve për zgjedhje, të cilat i dërgohen KKZ-së, KVV-së, si dhe ekipeve që dërgohen në përfaqësi diplomatike. KQZ-ja me akt nënligjor përcakton ekipet, procedurat e pranimit, transportimit, paketimit dhe



vlefshmërinë e zarfeve, duke përfshirë edhe ekipet që do të shkojnë të marrin dërgesat në kutitë postare jashtë Kosovës. Përbërja e ekipeve do të jetë e ngjashme me Këshillat e Votimit në përfaqësi diplomatike dhe do të drejtohen nga një zyrtar i përzgjedhur nga KQZ. Materialet zgjedhore apo që ndërlidhen me votimin jashtë vendit, kanë statusin e dërgesës diplomatike”.

Me nenin 96 paragrafi 1 dhe 2 të LZP-së, përcaktohet se: “1. Shtetasi me të drejtë vote, i cili jeton jashtë Kosovës, mund të votojë për zgjedhje nëse ai ose ajo aplikon dhe regjistrohet suksesshëm për votim jashtë Kosovës. 2. Vota përmes votimit jashtë Kosovës, e dërguar me postë në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë, pranohet nga KQZ-ja deri të nesërmen e ditës së zgjedhjeve në orën 16:00, me kusht që të ketë vulën e dërgimit para ditës së zgjedhjeve. Ndërsa, votat e dërguara përmes postës në kutinë postare jashtë Kosovës, të hapur nga përfaqësitë diplomatike, me autorizim të KQZ-së, pranohen nga ekipet që dërgon KQZ-ja, vetëm ato që kanë arritur në kutinë postare, më së voni deri në orën e mbylljes së vendvotimeve në përfaqësinë diplomatike”.

Me nenin 16 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores zgjedhore Nr. 12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, përcaktohet se: “1. Fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm nëse: 1.1. Është i vulosur; 1.2. ka numrin serik të VV përkatës. 2. Vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit: 2.1. në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e vlefshme nëse votuesi ka votuar për një (1) subjekt politik; 2.2. në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e pavlefshme, në rastet kur: 2.2.1. Kur votohet më shumë se një subjekt politik; 2.2.2. kur nuk votohet asnjë subjekt politik; 2.2.3. kur votohen vetëm kandidatët dhe jo subjekti politik; 2.2.4. kur qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim”.

Me nenin 17 të Rregullore Nr. 17/2024 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, përcaktohet se: “Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR”.

Me nenin 20 paragrafi 1 dhe 9 të Rregullore Zgjedhore Nr.14/2024 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, përcaktohet se: “ 1. (KQZ - obligohet të garantojë transparencë të plotë të numërimit të votave në QNR, duke përfshirë mundësinë e përdorimit të teknologjisë në monitorimin, leximin apo skanimin e materialeve. 9. Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike”.

Me nenin 45 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: 1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë ikufizohet me vendim gjyqësor. 2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. 3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike”.

Gjykata Supreme e Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave dhe nga dispozita e lartcekur, erdhi në përfundim se ankesa e ankuesit është e pabazuar, ndërsa vendimi i PZAP-së është i drejtë dhe i ligjshëm.



Në raport me pretendimet e ankuesit, se vendimi i KQZ-së për pranimin e fletëvotime përfshirë 23,232 pako me fletëvotime të pranuar më datat 02.01.2026, 05.01.2026 dhe 08.02.2025, si dhe vendimi i PZAP-së për refuzimin e ankesës është i pa bazuar dhe në kundërshtim me nenin 96 paragrafi 2 i LZP-së, këtë pretendim Gjykata Supreme e Kosovës e refuzon në tërësi si të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se kërkesa për anulimin e votave të pretenduara nga ankuesi është në tërësi e pabazuar si në aspektin juridik, ashtu edhe në aspektin faktik. Në radhë të parë, duhet theksuar se pranimi i këtyre votave është bërë në bazë të një vendimi të organit kompetent, përkatësisht Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili gëzon autoritet kushtetues dhe ligjor për administrimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e procesit zgjedhor. Vendimi i KQZ-së, përmes të cilit është legjitimuar pranimi i këtyre votave, ka prodhuar efekte juridike të plota dhe ka qenë në fuqi në momentin e zbatimit të tij.

Përveç kësaj, është me rëndësi të veçantë fakti se ky vendim i KQZ-së nuk është atakuar asnjëherë nga asnjë palë e interesit, as përmes mjeteve juridike të parapara me ligj dhe as brenda afateve procedurale përkatëse. Mos ushtrimi i mjeteve juridike kundër këtij vendimi nënkupton pranimin e tij të heshtur dhe konsolidimin e plotë të fuqisë së tij juridike. Në këtë kontekst, çdo përpjekje e mëvonshme për të kontestuar pasojat e një vendimi të tillë, pa e pasur më parë të kontestuar vetë vendimin, bie ndesh me parimet themelore të sigurisë juridike, stabilitetit të rendit juridik dhe besimit të ligjshëm në veprimet e autoriteteve publike.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se interpretimi strikt dhe i izoluar i nenit 96 paragrafi 2, pa e vënë atë në raport me kompetencat e KQZ-së dhe me rrethanat konkrete të rastit, çon në një qasje formaliste që nuk i shërben as qëllimit të ligjit zgjedhor dhe as mbrojtjes së vullnetit të lirë të votuesve. Legjislacioni zgjedhor duhet të interpretohet gjithmonë në frymën e garantimit të së drejtës së votës dhe të reflektimit sa më të saktë të vullnetit qytetar, për aq kohë sa nuk ka shkelje thelbësore që cenojnë integritetin e procesit zgjedhor.

Në këtë drejtim, duhet theksuar se vetë votat në fjalë janë të rregullta në përmbajtje dhe në mënyrën e administrimit të tyre. Procesi i votimit ka zhvilluar në mënyrë të rregullt, pa parregullsi substanciale, pa indicie për manipulim, presion ndaj votuesve apo shkelje të fshehtësisë dhe lirisë së votës. Procedurat e identifikimit të votuesve, administrimit të fletëvotimeve, numërimit dhe verifikimit kanë qenë në përputhje me standardet ligjore dhe praktikat zgjedhore të konsoliduara.

Për më tepër, anulimi i këtyre votave, në mungesë të shkeljeve reale dhe të provuara, do të përbente një masë disproporcionale, e cila do të dëmtonte drejtpërdrejt të drejtën kushtetuese të votuesve dhe do të deformonte rezultatin zgjedhor. Parimi i proporcionalitetit kërkon që sanksionet apo masat korrigjuese në procesin zgjedhor të aplikohen vetëm atëherë kur janë të domosdoshme dhe të justifikuara nga shkelje serioze që kanë ndikuar ose kanë pasur potencial real të ndikojnë në rezultat.

Si rezultat i kësaj, duke pasur parasysh se pranimi i votave është bërë në bazë të një vendimi të vlefshëm dhe të pa ankimuar të KQZ-së, dhe shtu faktin se votat janë të rregullta dhe se procesi i votimit ka rrjedhur në mënyrë korrekte, pretendimet për anulimin e tyre për shkak të tejkalimit të afatit sipas nenit 96 nuk qëndrojnë. Një qasje e tillë do të ishte në kundërshtim me parimet e



sigurisë juridike, të mbrojtjes së vullnetit të votuesve dhe të funksionimit normal të rendit zgjedhor demokratik.

Për më tepër, duhet theksuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi i vetëm kushtetues dhe ligjor kompetent për administrimin, organizimin dhe mbikëqyrjen e tërësishme të procesit zgjedhor, përfshirë edhe rregullimin e procedurës së votimit, pranimin e pakove me fletëvotime dhe përcaktimin e modaliteteve teknike dhe procedurale që lidhen me këto veprime. Kompetencat e KQZ-së nuk janë formale apo deklarative, por përfshijnë autoritetin vendimmarrës për të adresuar situata konkrete që paraqiten gjatë procesit zgjedhor, gjithmonë në funksion të garantimit të integritetit të procesit dhe realizimit efektiv të së drejtës së votës.

Në këtë kuptim, çdo vendim i nxjerrë nga KQZ-ja, për sa kohë është marrë brenda kompetencave të saj ligjore, gëzon prezumimin e ligjshmërisë dhe është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha palët e përfshira në proces. Legjislacioni zgjedhor parashikon qartë mekanizma juridikë për kontrollin e ligjshmërisë së vendimeve të KQZ-së, duke u dhënë palëve të interesuara të drejtën që t'i atakojnë këto vendime brenda afateve të përcaktuara ligjore. Këto afate nuk janë të rastësishme, por shërbejnë për të garantuar sigurinë juridike, dhe funksionimin efikas të procesit zgjedhor.

Mosshfrytëzimi i këtyre mjeteve juridike brenda afatit ligjor përbën heqje dorë nga e drejta për kontestim dhe ka për pasojë konsolidimin përfundimtar të vendimit administrativ të KQZ-së. Për rrjedhojë, nuk është e pranueshme që, pas përfundimit të afateve ligjore për ankimim, të vihet në dyshim ligjshmëria e veprimeve të KQZ-së në mënyrë indirekte, përmes kërkesave për anulim votash, pa u kontestuar më parë vetë vendimi që ka shërbyer si bazë për pranimin e tyre.

Në rrethanat konkrete, pranimi i pakove me fletëvotime është bërë pikërisht në zbatim të një vendimi të KQZ-së, i cili ka rregulluar administrimin e kësaj procedure. Përderisa ky vendim nuk është atakuar brenda afatit ligjor nga asnjë subjekt i autorizuar, ai ka marrë formë të prerë dhe është bërë pjesë e rendit juridik zgjedhor. Si i tillë, ai nuk mund të injorohet apo të relativizohet më vonë, pa cenuar parimet themelore të sundimit të ligjit dhe të sigurisë juridike.

Rrjedhimisht, duke marrë parasysh rolin dhe kompetencat e KQZ-së si organ rregullator i procedurës së votimit dhe pranimi të fletëvotimeve, si dhe faktin se çdo vendim i saj është i ankimeshëm vetëm brenda afateve ligjore të përcaktuara, rezulton qartë se pretendimet për anulimin e votave, të mbështetura në një kontestim të vonuar dhe të tërthortë të vendimeve të KQZ-së, janë juridikisht të pabazuara dhe nuk mund të pranohen.

Gjykata Supreme e Kosovës, qartëson faktin se pavarësisht se KQZ është organ kompetent për administrimin e procesit zgjedhor dhe caktimin e rregullave dhe modaliteteve zgjedhore, roli dhe kompetenca e KQZ-së nuk nënkupton, në asnjë rrethanë, se ky institucion ka autoritet të nxjerrë vendime në kundërshtim me ligjin apo të tejkalojë kufijtë e përcaktuar nga legjislacioni zgjedhor. Përkundrazi, edhe vetë KQZ-ja është e detyruar të veprojë në përputhje të plotë me ligjin dhe parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe barazisë së subjekteve zgjedhore. Asnjë vendim i saj nuk është i përjashtuar nga kontrolli juridik dhe asnjë akt administrativ i KQZ-së nuk mund të konsiderohet i paprekshëm.



Megjithatë, rendi juridik zgjedhor parashikon qartë se vlerësimi i ligjshmërisë së vendimeve të KQZ-së nuk bëhet në mënyrë abstrakte apo të vonuar, por përmes procedurave të rregullta të ankimit dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara. Pikërisht për këtë arsye, ligji u njeh palëve të interesuara të drejtën që çdo vendim të KQZ-së, për të cilin konsiderojnë se bie ndesh me ligjin, ta atakojnë përmes ankesës pranë organit kompetent, duke aktivizuar kështu mekanizmin institucional të kontrollit të ligjshmërisë.

Mos ushtrimi i së drejtës së ankimit brenda afatit ligjor nuk e shndërron një vendim potencialisht të kundërligjshëm në objekt debati të përhershëm, por përkundrazi sjell stabilizimin e tij juridik dhe prodhimin e efekteve të plota ligjore. Në këtë kuptim, nuk është e lejueshme që pas skadimit të afateve ligjore të kërkohej, në mënyrë indirekte, zhvleftësimi i pasojave të një vendimi të KQZ-së, duke u anashkaluar rruga e vetme e papaparë për vlerësimin e ligjshmërisë së tij.

Prandaj, fakti që pranimi i votave është bërë mbi bazën e një vendimi të KQZ-së nuk nënkupton legjitimim automatik të çdo vendimi pavarësisht përmbajtjes së tij, por nënkupton se çdo dyshim për kundërligjshmëri duhej të ishte ngritur në kohën e duhur dhe përmes instrumenteve juridike të parashikuara nga ligji. Në mungesë të një ankese të tillë, vendimi mbetet i vlefshëm dhe i detyrueshëm, ndërsa çdo pretendim i mëvonshëm për anulimin e votave, i bazuar në kontestimin e tërthortë të këtij vendimi, është juridikisht i papranueshëm.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.11/2026, datë 09.02.2026.

Kryetari i kolegjit,  
Qerim Ademaj



Republika e Kosovës  Republika Kosovo  
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

  
Punëtori i autorizuar  
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUBSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës  
Oznaka spisa:

AA-11/2026

PLETËDËRGESË PËR PARIZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

1. Pasi marrësi, i cili me krenim e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dërguar të bëhet dorëzimi i pas lëvizjes së kampionit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendjes në kohën e caktuar në batesh apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit natyror të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtës, fqit, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ina izvrši ni pošto ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena odraslom članu domaćin. Primaoca nastojnja zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtarin i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u ja në batesh në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në dërrën e batesh ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca ( pribeho na vrata stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më \_\_\_\_\_ 201 \_\_\_\_\_ në ora \_\_\_\_\_ cas.  
dona \_\_\_\_\_ u \_\_\_\_\_  
Shkak i refuzimit të marrjes \_\_\_\_\_  
Razlog odbijanja prijma \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Emri i shkresës që dorëzohet:  
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTIVIZIMI

09-02-2026

Numri i shkojave: \_\_\_\_\_  
broj priloga \_\_\_\_\_

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur  
më (me fjalë)  
Povrdjueno prijem gorenavegenog pisma  
( i slovima )

AKTIVIZIMI 09.02.2026

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që  
e ka marrë aktin në vend të tij  
Potpis primaoca ili licu koje je  
pismeno primilo u znanju)

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkallën pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpise, potpisuje ga dostaljac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Par 10/11